

VENDIM
Nr.84, datë 12.4.2007

PËR ZËVENDËSIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT
TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 6 dhe 34 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Saimir Sallaku emërohet anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, duke zëvendësuar zonjën Rajmonda Shaqiri për mandatin 3-vjeçar.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)